LIGJ
Nr. 44/2025

PËR ZYRËN E RIKUPERIMIT TË ASETEVE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i Zyrës së Rikuperimit të Aseteve (në vijim "ZRA"), me synimin për të lehtësuar procesin e gjurmimit e të identifikimit, si dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të rikuperimit të aseteve.

Neni 2
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për krijimin, organizimin, funksionimin dhe përcaktimin e përgjegjësive dhe të procedurave të bashkëpunimit të ZRA-së.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë

ZRA-ja ka si fushë veprimi lehtësimin e gjurmimit e të identifikimit të të ardhurave, aseteve dhe përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale, të cilat janë ose mund të jenë objekt i një vendimi sekuestrimi apo konfiskimi pas fillimit të procedimit penal.

---

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
- direktivën 2014/42/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 3 prill 2014, "Për bllokimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të produkteve të krimit në Bashkimin Evropian". Nr. CELEX 32014L0042, Fletorja Zyrtare, Seria L, Nr. 127, datë 19.4.2014, f. 30–50;
- direktivën (BE) 2019/1153 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit , të datës 20 qershor 2019, që përcakton rregullat që lehtësojnë përdorimin e informacioneve financiare dhe të tjera për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të veprave të caktuara penale, dhe shfuqizimin e vendimit të Këshillit 200 642/JHA, e ndryshuar. Nr. CELEX 32019L1153, Fletorja Zyrtare, Seria L, Nr. 186, datë 11.7.2019, f. 122–137;
- direktivën (BE) 2023/977 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 10 maj 2023, mbi shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit të shteteve anëtare dhe shfuqizimin e vendimit kornizë të Këshillit 2006/960/jha. Nr. CELEX 32023L0977, Fletorja Zyrtare, Seria L, nr. 134, datë 22.5.2023, f 1–24;
- direktivën 2024/1260/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 prill 2024, "Për rikuperimin e aseteve dhe konfiskimin". Nr. CELEX 32024L1260, Fletorja Zyrtare, Seria L, nr. 2024/1260, datë 2.5.2024, f. 1–24;
- vendimin e Këshillit 2007/845/JHA, të 6 dhjetorit 2007, në lidhje me bashkëpunimin midis zyrave të rikuperimit të pasurive të shteteve anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave nga, ose pronave të tjera që lidhet me krimin. Nr. CELEX 32007D0845, Fletorja Zyrtare, Seria L, nr. 332, datë 18.12.2007, f. 103–105.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Asete (pasuri)" janë të drejta apo interesa pasurorë të çdo lloji mbi sende të luajtshme, të paluajtshme, të trupëzuara ose të patrupëzuara, materiale ose jomateriale, përfshirë edhe ato të evidentuara në formë elektronike apo numerike (digjitale), duke përfshirë, por pa u kufizuar në instrumente të tilla, si: kreditë, çeqet e udhëtimit, çeqet bankare, urdhërpagesat, të gjitha llojet e titujve, mandatpagesat dhe letrat e kreditit, si dhe çdo interes, dividend, e ardhur apo vlerë tjetër që buron prej tyre;

b) "Informacion dhe inteligjencë" është çdo lloj e dhënë, që mbahet nga autoritetet ligjzbatuese, autoritetet publike ose nga subjektet private dhe që janë në dispozicion të autoriteteve ligjzbatuese pa marrë masa shtrënguese e që mund të jepet në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

c) "Konfiskimi" është marrja e përhershme e pasurisë dhe kalimi i saj në favor të shtetit;

ç) "Pavarësi operacionale" është kryerja e veprimtarisë operacionale në mënyrë të pavarur nga ndikimet dhe ndërhyrjet, që mund të cenojnë efektivitetin dhe paanshmërinë e saj;

d) "Përfitime të tjera pasurore" janë çdo përfitim i mundshëm i pasurisë;

dh) "Sekuestrimi" është ndalimi i çdo transanksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) "Shkëmbim informacioni" është shkëmbimi i atij lloj informacioni dhe inteligjence apo edhe prove, të cilat janë në dispozicion të autoriteteve shqiptare dhe që mund të jenë të dobishme për ecurinë e procedimeve penale të regjistruara ose mund të ndihmojnë në përfundimin e hetimeve penale në juridiksione të tjera me autoritetet e huaja, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 5
Parimet bazë

Parimet bazë mbi të cilat udhëhiqet ZRA-ja në veprimtarinë e saj janë:

a) ligjshmëria;
b) respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
c) llogaridhënia;
ç) profesionalizmi;
d) transparenca;
dh) ruajtja e konfidencialitetit dhe e sekretit hetimor;
e) paanshmëria;
ë) mbrojtja e interesit publik.

KREU II
ORGANIZIMI

Neni 6
Organizimi i ZRA-së

1. Zyra e Rikuperimit të Aseteve është strukturë e veçantë e Policisë së Shtetit, e cila gëzon pavarësi operacionale gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

2. Struktura dhe organika (organizimi i brendshëm) e ZRA-së hartohen në përputhje me përgjegjësitë funksionale të parashikuara në këtë ligj, duke respektuar standardet e organizimit në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Buxheti i ZRA-së është pjesë e programit buxhetor, të emërtuar "Policia e Shtetit".

3. Procedurat standarde të veprimit miratohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, me propozimin e drejtorit të ZRA-së.

Neni 7
Drejtori i ZRA-së

1. Drejtori i ZRA-së përfaqëson pikën e kontaktit të Republikës së Shqipërisë me zyrat homologe të vendeve të tjera, si dhe rrjetet ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve.

2. Drejtori i ZRA-së është përgjegjës për organizimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së ZRA-së.

3. Drejtori i ZRA-së përgjigjet para drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për realizimin e performancës dhe objektivave të përcaktuar.

4. Drejtori i ZRA-së emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

5. Drejtori i ZRA-së emërohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit pas kryerjes së një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues, bazuar në parime të mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat e procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të ZRA-së përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.

6. Drejtori i ZRA-së qëndron në detyrë për 4 (katër) vjet me të drejtë riemërimi edhe për një mandat të dytë.

7. Kandidati për t'u emëruar drejtor i ZRA-së duhet të përmbushë këto kritere:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të mbajë së paku njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues;

ç) të mos jetë i përjashtuar nga Policia e Shtetit, strukturat e tjera të sigurisë kombëtare apo të jetë larguar nga shërbimi civil me masë disiplinore;

d) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht për të kryer detyrën;

dh) të ketë mbaruar arsimin e lartë;

e) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

8. Drejtori i ZRA-së lirohet nga detyra kur:

a) mbush moshën për pension pleqërie;

b) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor, sipas ligjit;

c) jep dorëheqjen;

ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të pranimit;

d) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së tij;

dh) humbet shtetësinë shqiptare;

e) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

ë) nuk pajiset me Certifikatën e Sigurisë së Personelit pas dy aplikimeve të njëpasnjëshme;

f) ka marrë dy vlerësime periodike vjetore të njëpasnjëshme "jo mjaftueshëm" për rezultatet në punë;

g) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit dhe, sipas ligjit, nuk merr masat e parashikuara për shmangien e konfliktit të interesit brenda afatit të përcaktuar.

9. Drejtori i ZRA-së shkarkohet nga detyra kur:

a) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;

b) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;

c) ka performancë të ulët në kryerjen e detyrës.

Neni 8
Punonjësit e ZRA-së

1. Punonjësit e ZRA-së përzgjidhen nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Kandidatët për punonjës të ZRA-së i nënshtrohen verifikimit të integritetit/pastërtisë së figurës nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen policore në ministrinë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

3. Për emërimin, transferimin, disiplinën, vlerësimin e performancës dhe lirimin e punonjësve të ZRA-së zbatohen rregullat e procedurat e parashikuara në ligjin për Policinë e Shtetit dhe për Policinë Gjyqësore.

4. Punonjësit e ZRA-së gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore, në përputhje me legjislacionin procedural penal e me ligjin për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

KREU III
FUNKSIONET DHE DETYRAT

Neni 9
Përgjegjësitë funksionale

ZRA-ja është përgjegjëse për:

a) lehtësimin e bashkëpunimit të agjencive kombëtare ligjzbatuese me agjencitë ligjzbatuese të vendeve ku janë krijuar dhe funksionojnë ZRA-të homologe, me qëllim gjurmimin dhe identifikimin e të ardhurave, aseteve dhe përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale, të cilat janë ose mund të jenë objekt i një vendimi sekuestrimi apo konfiskimi pas fillimit të procedimit penal;

b) shkëmbimin e informacionit me organet ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare për rastet për të cilat ka filluar një procedim penal, për të ndihmuar në gjurmimin e identifikimin e të ardhurave, aseteve ose përfitimeve pasurore nga aktivitetet kriminale, në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe marrëveshjet e zbatueshme të bashkëpunimit;

c) shkëmbimin e praktikave dhe të metodave me organet ligjzbatuese kombëtare e ndërkombëtare për të përmirësuar gjurmimin dhe rikuperimin e aseteve, duke siguruar përputhjen me standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe duke u fokusuar në teknikat procedurale, por jo në informacione të ndjeshme specifike për çështje konkrete;

ç) mbledhjen e statistikave lidhur me gjurmimin e identifikimin e të ardhurave, aseteve dhe përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale, sipas legjislacionit në fuqi;

d) bashkëpunimin me rrjetet ndërkombëtare të rikuperimit të aseteve dhe me organizma të tjerë, që konsiderohen të përshtatshëm në funksion të kryerjes së veprimtarisë së ZRA-së, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 10
Detyrat e ZRA-së

1. Detyrat e ZRA-së janë si më poshtë:

a) për veprimtari që janë brenda fushës së saj të veprimit, ka akses në regjistrin qendror të llogarive bankare dhe në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas niveleve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për regjistrin qendror të llogarive bankare dhe në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Aksesi kryhet rast pas rasti nga personeli i ZRA-së, që është trajnuar, caktuar e autorizuar në mënyrë specifike për të kryer këtë detyrë. Personeli i ZRA-së vepron në respekt të rregullave profesionale të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;

b) shkëmben informacion dhe analiza financiare me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara dhe me Agjencinë e Inteligjencës Financiare;

c) shkëmben informacion dhe të dhëna me autoritete kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me gjurmimin e identifikimin e të ardhurave, aseteve ose përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) administron e analizon informacione dhe raporte, si dhe kryen analiza të thelluara për çështje të lidhura me asetet, që janë produkt i veprimtarisë kriminale, duke përdorur forma, metoda e mjete pune të analizës dhe të vlerësimit të informacionit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për këtë qëllim;

d) mbledh dhe përpunon periodikisht statistika në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, në përputhje me përcaktimet e udhëzimit të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2. ZRA-ja mbledh, ruan e përpunon statistika të siguruara nga organet kombëtare të drejtësisë dhe organet kombëtare, që kryejnë veprimtari të hetimit financiar, dhe përditëson një bazë elektronike të dhënash për:

a) kërkesat e marra dhe të dërguara nga/për ZRA-të homologe;

b) kërkesat e marra dhe të dërguara në kuadër të ndërveprimit të ZRA-së me agjenci ligjzbatuese brenda vendit;

c) marrjen e dërgimin e raporteve mbi praktikat e ndjekura;

ç) marrjen e dërgimin e informacionit të ndarë kryesisht;

d) statistika mbi masat e sekuestrimit e të konfiskimit.

3. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij neni bëhet në bazë të kërkesës së marrë ose në përputhje me praktikat e shkëmbimit kryesisht të informacionit, sipas përcaktimit në këtë ligj.

Neni 11

Aksesi dhe shkëmbimi i informacionit

1. ZRA-ja ka akses të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit, si dhe në ato që lidhen me qëllimin e objektin e veprimtarisë së saj në çdo lloj regjistri publik lidhur me të dhënat për asetet, në regjistra të përqendruar të dhënash për kontrata dhe/ose detyrime të subjekteve private me organe të shtetit, regjistrat noterialë, të dhënat mbi të gjitha llojet e mjeteve tokësore, detare dhe ajrore, të dhënat tatimore e doganore, të dhënat mbi marrëdhënie të mundshme biznesi, veprimtari tregtare ose veprimtari të tjera profesionale.

2. Çdo veprimtari ndërhyrëse apo njohje me të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni është e gjurmueshme dhe regjistrohet në një regjistër të posaçëm. Në këtë regjistër regjistrohen për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet të dhënat e mëposhtme:

a) data dhe ora e aksesimit të të dhënave;

b) përdoruesi apo procesi që lidhet me aksesimin;

c) përshkrimi i veprimeve të bëra për aksesimin;

ç) dështimi apo suksesi i ngjarjes;

d) burimi i të dhënave (p.sh. emri i sistemit);

dh) vendndodhja/identifikimi i vendit ku ka ndodhur.

3. Institucionet apo subjektet, që disponojnë këto të dhëna, janë të detyruara të bashkëpunojnë dhe t'i japin aksesin e kërkuar për informacion ZRA-së.

4. ZRA-ja mund të ketë akses për informacione e të dhëna të tjera në bazat e të dhënave nëse ky veprim është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në marrëveshje me institucionin përkatës.

5. ZRA-ja, mbi bazë të një kërkese nga organet kombëtare që marrin pjesë në hetimin financiar, ndan informacione apo të dhëna të disponueshme apo që mund të përftohen përmes bashkëpunimit me zyrat e huaja homologe, në funksion të gjurmimit dhe të identifikimit të të ardhurave, aseteve dhe përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale, të cilat janë ose mund të jenë objekt i një vendimi sekuestrimi apo konfiskimi pas fillimit të procedimit penal.

Neni 12

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i praktikave me rrjetet ndërkombëtare

1. ZRA-ja, në përmbushje të misionit dhe të përgjegjësive ligjore, bashkëpunon me pikat e kontaktit të agjencive të zbatimit të ligjit në Rrjetin Ndërinstitucional të Rikuperimit të Aseteve Camden, Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, si dhe rrjetet e tjera të rikuperimit të aseteve.

2. Bashkëpunimi me rrjetet e rikuperimit të aseteve synon përmirësimin e njohurive të ndërsjella të metodave dhe teknikave të bashkëpunimit operacional në fushën e gjurmimit e të identifikimit ndërkufitar të të ardhurave, aseteve dhe përfitimeve të tjera pasurore, që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me një vepër penale ose veprimtari kriminale.

3. ZRA-ja shkëmben praktika me zyrat e huaja homologe për të përmirësuar efektivitetin e veprimeve për identifikimin e të ardhurave, aseteve ose përfitimeve të tjera pasurore, që lindin nga një vepër penale, veprimtari kriminale ose që janë të lidhura me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 13
Mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave personale dhe atyre të klasifikuara "sekret shtetëror"

1. Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i të dhënave personale dhe atyre të klasifikuara "sekret shtetëror" kryhet në përputhje me parimet, kriteret, si dhe masat tekniko-organizative të zbatueshme për garantimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, për informacionin e klasifikuar dhe marrëveshjet ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.
2. Vetëm personat e autorizuar dhe të trajnuar nga ZRA-ja mund të kenë akses në përpunimin e të dhënave personale dhe detyrohen të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të funksionit që kryejnë, sipas qëllimeve të këtij ligji.
3. Të dhënat personale mbahen për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin e identifikimit, gjurmimit dhe rikuperimit të aseteve, por jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Të dhënat rishikohen periodikisht, të paktën çdo 3 (tre) vjet, për të përcaktuar nëse mbajtja e vazhdueshme është e justifikuar dhe i shërben qëllimit të grumbullimit dhe përpunimit të tyre.
4. Për rastet që lidhen me terrorizmin ose kërcënimet serioze për sigurinë kombëtare, të dhënat personale mund të ruhen deri në 10 (dhjetë) vjet, duke iu nënshtruar rishikimit periodik çdo 5 (pesë) vjet për të konfirmuar se mbajtja e tyre është e nevojshme dhe i shërben qëllimit për të cilin janë grumbulluar e përpunuar.
5. Të dhënat personale, që nuk konsiderohen më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur e përpunuar, fshihen në mënyrë të sigurt, në përputhje me standardet e mbrojtjes së të dhënave.

KREU IV
BASHKËPUNIMI ME ORGANET DHE INSTITUCIONET KOMBËTARE

Neni 14
Pikat e kontaktit për ZRA-në

1. Organet kombëtare të drejtësisë, organet kombëtare që kryejnë veprimtari të hetimit financiar dhe autoritetet e tjera kombëtare, bashkëpunimi me të cilat i shërben përmbushjes së misionit dhe përgjegjësive të ZRA-së, me kërkesë të drejtorit të ZRA-së, caktojnë një pikë kontakti.
2. Organet e përmendura në pikën 1 të këtij neni informojnë menjëherë ZRA-në në rast ndryshimi të pikës së tyre të kontaktit.

Neni 15
Mënyra e komunikimit

1. ZRA-ja komunikon në rrugë elektronike zyrtare nëpërmjet pikave të kontaktit të institucioneve kombëtare, sipas pikës 1 të nenit 14, të këtij ligji, bazuar mbi një kërkesë, sipas formatit të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, të nënshkruar në mënyrë elektronike, e cila përmban të gjitha elementet e një kërkese zyrtare ose të një kërkese të verifikuar përmes një certifikate digjitale të lëshuar, në përputhje me legjislacionin për nënshkrimin elektronik.
2. Kur komunikimi në rrugë elektronike, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk është i mundur, komunikimi ndërmjet ZRA-së dhe pikave të kontaktit kryhet përmes korrespondencës zyrtare shkresore.
3. Në rastet urgjente, kopja e skanuar e kërkesës mund të dërgohet përmes e-mail-it zyrtar, me kusht që kërkesa origjinale të përcillet menjëherë përmes postës në ZRA.

Neni 16
Dorëzimi i kërkesave pranë ZRA-së

1. Organet kombëtare të drejtësisë dhe organet kombëtare, që kryejnë veprimtari të hetimit financiar, përmes pikave të kontaktit, mund të paraqesin në mënyrë elektronike kërkesat në ZRA për të marrë informacion mbi asetet në pronësi të personit fizik ose juridik, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi.

2. Kërkesa, në varësi të rrethanave të rastit, duhet të përmbushë elementet e kërkuara për kërkesat drejtuar ZRA-së, në përputhje me përcaktimet e aktit nënligjor të miratuar në zbatim të këtij ligji.

3. ZRA-ja ia përcjell pa vonesë kërkesën ZRA-së homologe të shtetit të huaj dhe, pas marrjes së përgjigjes, e përcjell atë menjëherë pranë organit kërkues përmes pikës së kontaktit.

Neni 17
Dorëzimi i njoftimeve në ZRA

Organet kombëtare të drejtësisë, organet kombëtare që kryejnë veprimtari të hetimit financiar dhe autoritetet e tjera kombëtare, bashkëpunimi me të cilat i shërben përmbushjes së misionit dhe përgjegjësive të ZRA-së, informojnë ZRA-në përmes pikës së kontaktit për vendimet e përcjella nga gjykata në kuadër të veprimtarisë së saj.

KREU V
BASHKËPUNIMI ME ZRA-TË E HUAJA

Neni 18
Mënyra e komunikimit

1. ZRA-ja për shkëmbimin e informacionit përdor si mjet komunikimi aplikacionin e Rrjetit të Sigurt të Shkëmbimit të Informacionit "SIENA".

2. Kur është e nevojshme dhe në raste përjashtimore, ZRA-ja komunikon drejtpërdrejt me zyrat e huaja homologe në mënyra elektronike zyrtare dhe të sigurta.

3. Komunikimi ndërmjet zyrave të rikuperimit të aseteve bëhet përmes kanaleve të komunikimit elektronik.

4. Kur komunikimi elektronik nuk është i mundur, zbatohet forma zyrtare e komunikimit,sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19
Kërkesat e ardhura nga jashtë

1. Bashkëpunimi ndërmjet ZRA-ve ndërmerret në përputhje me instrumentet dhe praktikat më të mira evropiane në lidhje me lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës dhe në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

2. Kërkesa e ardhur nga jashtë, e cila duhet të jetë e arsyetuar, duhet të përmbajë:

a) objektin e kërkesës;

b) arsyet e kërkesës, duke përfshirë rëndësinë e informacionit të kërkuar për gjurmimin dhe identifikimin e pasurisë përkatëse;

c) llojin e pasurisë;

ç) llojin e veprës penale me të cilën lidhet kërkesa, si dhe përmbajtjen e dispozitave përkatëse të legjislacionit penal të shtetit kërkues për veprën penale së cilës i referohet;

d) detaje mbi pasurinë që kërkohet, siç janë llogaritë bankare, pasuritë e paluajtshme, automjetet, anijet, avionët, kompanitë dhe sendet e tjera me vlerë të lartë;

dh) kur është e nevojshme për identifikimin e personave fizikë ose juridikë të përfshirë, çdo dokument identifikimi, nëse është i disponueshëm, si dhe detaje të tilla, si: emri, shtetësia, vendi i banimit, numrat e identifikimit, adresat, data dhe vendi i lindjes, data e regjistrimit, vendi i themelimit, aksionarët, selia dhe filialet, sipas rastit;

e) për kërkesat urgjente, arsyet për urgjencën e kërkesës.

Neni 20
Afatet për shqyrtimin e kërkesave

1. Afatet për shqyrtimin e kërkesave drejtuar ZRA-së janë:
a) 7 (shtatë) ditë nga momenti i marrjes së kërkesës për kërkesat që nuk janë urgjente;
b) 8 (tetë) orë nga momenti i marrjes së kërkesës për kërkesat urgjente të lidhura me kategori të tilla informacioni për të cilat ZRA-ja ka akses të menjëhershëm; dhe
c) 3 (tri) ditë nga marrja e kërkesës për kërkesat urgjente nëse ZRA-ja duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të dhënë informacion nëpërmjet autoriteteve të tjera kombëtare.
2. Kur ekzistojnë arsye për të cilat kërkesa e marrë nuk mund të përmbushet brenda afatit të përcaktuar, ZRA-ja është e detyruar të njoftojë menjëherë autoritetin që ka paraqitur kërkesën, si dhe merr masat për dërgimin e informacionit të kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, brenda një afati shtesë prej 7 (shtatë) ditësh për kërkesat e paraqitura sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, dhe brenda një afati shtesë prej 3 (tri) ditësh për kërkesat e paraqitura sipas shkronjave "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni.

Neni 21
Afatet për kërkesat e ZRA-së ndaj autoriteteve kombëtare

1. Kur ZRA-ja kërkon informacion nga autoritetet kombëtare, të nevojshëm për gjurmimin dhe rikuperimin e aseteve, këto institucione përgjigjen brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e kërkesës.
2. Për kërkesat urgjente, informacioni i kërkuar nga ZRA-ja përcillet nga autoritetet kombëtare brenda 3 (tri) ditëve punë.
3. Në rast se autoriteti kombëtar nuk mund të përmbushë afatin kohor të specifikuar, ai duhet të njoftojë menjëherë ZRA-në duke dhënë një arsye të vlefshme për vonesën dhe një afat kohor të parashikuar për përgjigje.

Neni 22
Refuzimi i një kërkese të dërguar nga institucionet homologe të huaja

1. Zyra e Rikuperimit të Aseteve refuzon përmbushjen e një kërkese për një ZRA të huaj, bazuar në rastet e mëposhtme:
a) kur mund të dëmtohen siguria kombëtare, rendi publik dhe interesat e tjerë thelbësorë të shtetit;
b) kur mund të dëmtohet ecuria e një hetimi aktual, e një operacioni të inteligjencës në fushën penale ose siguria e individëve;
c) kur qëllimi për të cilin kërkohet informacioni është jo në proporcion me interesat e ligjshëm të një personi ose është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është bërë kërkesa.
2. Për refuzimin e kërkesës njoftohet pa vonesë institucioni homolog i huaj, shoqëruar me një raport shpjegues, ku përcaktohet arsyeja e refuzimit.

KREU VI
DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Neni 23
Dispozita transitore

1. Drejtori i ZRA-së emërohet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Deri në plotësimin e strukturës së ZRA-së, drejtori i ZRA-së mbështetet në detyrat e tij nga punonjës të strukturave të analizës së informacionit kriminal dhe të hetimit në Policinë e Shtetit.

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet ministri i Brendshëm për miratimin e udhëzimit sipas pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ngarkohet drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për miratimin e urdhrave të përcaktuar në nenet 6, pikat 2 dhe 3, dhe 15, pika 1, të këtij ligji.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.6.2025.

Shpallur me dekretin nr. 222, datë 8.7.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.